

UDHËZUES PRAKTIK PËR PARANDALIMIN E TORTURËS NË VENDET E PARABURGIMIT DHE NË BURGJE



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tiranë më, Janar 2023

Hartimi i këtij Udhëzuesi Praktik realizohet në kuadër të mbështetjes institucionale të ofruar nga Sigrid Rausing Trust Foundation, kundrejt Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Përmbajtja e këtij udhëzuesi u konsultua me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Përmbajtja e këtij udhëzuesi është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht ato të Sigrid Rausing Trust Foundation.

THE SIGRID RAUSING TRUST

Përgatiti:

Znj. Vasilika Hysi, Eksperte e Jashtme Ligjore e Nivelit të Lartë

Redaktimi letrar:

Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Menaxhere Projektesh, KShH

Znj. Rabie Zika, Paraligjore/Asistente Projektesh, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

© Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë udhëzues,
mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati "Tekno Projekt" Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752; Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;
E-mail:office@ahc.org.al; Web site: www.ahc.org.al

I. Ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese 9

Çfarë parashikon Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në lidhje me torturën?	9
Cilat sjellje ose veprime përbëjnë torturë?	9
-Cilat sjellje ose veprime përbëjnë trajtim ose ndëshkim çnjerëzor/poshtërues?	10
Kush mund të jetë subjekt i veprave penale të torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues?	11
Kush janë personat më të rrezikuar për të qenë viktimë të torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues?	11
Raste ilustruese.	11

II. Kushtet, trajtimi mjekësor në vendet e paraburgimit, burgje dhe parandalimi i keqtrajtimit 13

Pse ka rëndësi momenti i pranimit në institucion?	13
Kontrolli fizik dhe intim;	13
Kushtet materiale të jetesës;	14
Hapësira e jetesës dhe mbipopullimi;	14
Kushtet higjienike;	15
Ndriçimi dhe ajrimi;	15
Raste ilustruese;	16
Trajtim mjekësor i përshtatshëm sipas nevojave të të burgosurit;	17
Ekzaminimet, diagnostikimi, parandalimi i sëmundjeve dhe kujdesi shëndetësor;	17

Ndërhyrjet mjekësore të nevojshme;	18
Trajtimi i personave me probleme të shëndetit mendor;	19
Trajtimi mjekësor i pavullnetshëm;	20
Ushqyerja e të burgosurit me detyrim;	22
Lirimi i personit të privuar nga liria për shkak të gjendjes shëndetësore;	22
Raste ilustruese.	23

III Regjimi në institucion dhe ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues 26

Regjimi në institucion dhe zbatimi i tij;	26
Mbikqyrja e veçantë;	26
Përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit/shtrëngimit fizik;	27
Cili janë garancitë që duhen të respektohen në rast të përdorimit të forcës?	28
Caktimi i masave disiplinore sipas një procesi të rregullt ligjor;	29
Masat disiplinore dhe kategoritë e veçanta;	30
Raste ilustruese.	31

IV. Masat parandaluese dhe mekanizmat mbrojtës ndaj torturës, trajtimit ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese 32

Cilat janë detyrimet e shtetit për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese?	32
Pse janë të nevojshme masat parandaluese?	32
Cilat janë garancitë për parandalimin e keqtrajtimit të një personi të privuar?	33
Cilat janë masat parandaluese për keqtrajtimin e një personi të privuar?	33

Pse ka rëndësi evidentimi i shenjave të keqtrajtimit të personit të privuar nga liria?	34
Mekanizmi i kërkesë/ankesës brenda dhe jashtë institucionit;	35
Përgjegjësitë e personelit të shërbimit të burgjeve për të raportuar rastet e keqtrajtimit;	35
Cilat janë detyrimet pozitive të institucionit në rast se pretendohet për një rast keqtrajtimi?	36
A ka të drejtë i burgosuri të ankohet për mungesë të hetimeve efektive?	36

V. Mekanizmat mbrojtës institucionalë për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese

37

Inspektimet e brendshme dhe monitorimet;	37
Mekanizmi Parandalues Kombëtar, Avokati i Popullit	37
Komisioni i ekzekutimit të vendimeve penale;	38
Monitorimi nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatat vendase të të drejtave të njeriut;	38
Mekanizmat parlamentarë;	39
Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT);	39
Monitorime nga organizata të tjera ndërkombëtare;	39
Çfarë parashikon raporti i KPT për Shqipërinë lidhur me keqtrajtimet në burgjet shqiptare?	40
Cilat janë detyrimet e shtetit shqiptar në përmbushje të rekomandimeve të KPT-së?	40
Disa gjetje dhe rekomandime kryesore të Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KPT-së për Shqipërinë 2022.	41

VI. Drejtësia penale, gjykatat dhe ndëshkimi i torturës

43

Çfarë parashikon Kodi Penal në lidhje me veprat penale të torturës dhe keqtrajtimit? 43

Ku dhe si mund të raportohet një rast keqtrajtimi? 44

A ka të drejtë një person i keqtrajtuar të përfitojë mbrojtje ligjore falas? 44

A ka të drejtë personi i keqtrajtuar të kërkojë një mjek ligjor të pavarur dhe cili është roli i mjekut ligjor? 44

E drejta e viktimës për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në proces; 45

Dëmshpërblimi i viktimës; 45

E drejta për për t'u drejtuar gjykatës dhe Gjykatës Kushtetuese; 45

E drejta për t'u drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. 46

Hyrje

1. Çfarë na nxiti për të shkruar këtë udhëzues?

Çdo individ, pavarësisht statusit të tij, edhe nëse është i privuar nga liria gëzon të drejta dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të personave të privuar nga liria është e drejtë e çdo personi, pavarësisht rrezikshmërisë së tij dhe/ose veprës penale të kryer. Përmeshja dhe rritja e standardeve që mundësojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të çdo individit të privuar nga liria është detyrim i institucioneve. Raportet e organizmave monitoruese të të drejtave të njeriut tregojnë se tortura, trajtimi çnjerëzor ose poshtërues i personave të privuar nga liria janë të përhapura në stacionet/komisariatet e policisë, në vendet e paraburgimit dhe në burgje, në qendrat e kujdesit shëndetësor për personat me probleme të shëndetit mendor si dhe në qendrat ku mbahen azilkërkuesit ose emigrantët e parregullt. Të burgosurit janë të rrezikuar të jenë viktimat e torturës, keqtrajtimit, trajtimeve dhe dënimeve çnjerëzore dhe poshtëruese nga personeli i institucionit ose të burgosurit e tjerë.

Kushtet e jetesës, mbipopullimi, mungesa ose cilësia e kujdesit shëndetësor mund të çojnë në trajtim çnjerëzor dhe/ose degradues të të burgosurit. Keqtrajtimi i tyre mund të jetë pasojë e mungesës së garancive procedurale, të mangësive të organizimit në institucion dhe/ose mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme ose mund të jetë e vullnetshme.

Një ligj ose rregullore në dukje neutrale në formulim mund të çojë në trajtim degradues dhe poshtërues në praktikë nëse nuk mbahen në konsideratë nevojat individuale të të burgosurit. Keqtrajtimi, tortura ose trajtimi çnjerëzor ose poshtërues mund të shkaktohet edhe nga mosnjohja ose moszbatimi i ligjit. Ligji duhet të parashikojë të gjitha garancitë ligjore dhe institucionale për ndalimin e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues, për të parandaluar këto raste.

Mekanizmat parandalues dhe mbrojtës duhet të jenë efektive në praktikë dhe për çdo person të privuar nga liria, pa diskriminim. Nëse një person pretendon se është viktimë e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues, ai/ajo ka të drejtë të mbrohet në mënyrë efektive dhe se institucionet përgjegjëse detyrohen të kryejnë hetime efektive për rastin në fjalë.

2.Cili është qëllimi i udhëzuesit dhe kush janë përdoruesit e tij?

Ky udhëzues synon t'i vijë në ndihmë personelit bazë që punon në institucionin e mbyllur. Njohja dhe përvetësimi i tij do t'i ndihmojë ata për të dalluar veprimet dhe mosveprimet që mund të përmbajnë torturë ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues dhe masat që duhet të merren për t'i parandaluar ato. Gjithashtu, personeli do të rrisë përpjekjet për të respektuar standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në institucion. Udhëzuesi do të jetë i përdorshëm edhe nga shtetasit e burgosur, ndërgjegjësimi i të cilëve për të drejtat e tyre do të rritet. Ata do të jenë më të aftë të njohin të drejtat dhe liritë e tyre dhe të kërkojnë respektimin e tyre; të kërkojnë rritjen e llogaridhënies, të transparencës e përgjegjshmërisë së stafit të institucionit kundrejt tyre. Gjithashtu, udhëzuesi mund të shërbejë si udhëzues i thjeshtë për familjarët dhe të afërmit e personave të privuar nga liria.

Gjuha e përdorur në këtë udhëzues është thjeshtuar, ndërkohë që në çdo rast, çdo punonjës i institucionit në kryerjen e veprimeve administrative të tij duhet t'i referohet legjislacionit në fuqi dhe rregullores së brendshme të institucionit.

Termi i burgosur i përdorur në këtë udhëzues nënkupton çdo person, pavarësisht gjinisë, liria e të cilit është privuar dhe gjendet në një institucion paraburgimi ose të ekzekutimit të dënimit me burgim ose të njohur ndryshe si institucione të ekzekutimit të vendimeve penale.

I. Ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese

Çfarë parashikon Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në lidhje me torturën?

Neni 3 i KEDNJ parashikon se “Askush nuk vihet nën torturë ose trajtim ose ndëshkim çnjerëzor ose poshtërues.” Ky nen është shkruar shkurt, thjeshtë dhe qartë. Tre aktet e ndaluara nga Konventa janë: tortura, trajtimi çnjerëzor ose poshtërues dhe dënimi çnjerëzor ose poshtërues. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 25 të saj parashikon se “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”. Ndalimi i torturës është një e drejtë absolute, që do të thotë se nuk lejohet asnjë përfundim nga ky ndalim në çdo kohë, rrethanë dhe për çfarëdo lloj arsye. Këto akte ndalohen, pavarësisht faktit nëse personi ka kryer një vepër penale të rëndë, pavarësisht sjelljes së tij në institucion ose nëse personi është i rrezikshëm për shoqërinë.

Cilat sjellje ose veprime përbëjnë torturë?

Nuk ka një listë shteruese të sjelljeve dhe/ose veprimeve që mund të cilësohen torturë. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në vendimet e saj ka cilësuar veprime të ndryshme që mund të cilësohen torturë¹. Që një veprim të cilësohet torturë duhet të përmbushë tre elementë:

- të shkaktojë dhimbje ose vuajtje mendore ose fizike;
- shkaktimi i dhimbjes ose vuajtjes të jetë i qëllimshëm ose i paramenduar si për shembull, për të marrë informacion, ose një pohim përmes frikësimit;
- dhimbja ose vuajtja shkaktohen nga veprimet e personit që ushtron një funksion publik ose me nxitjen ose miratimin e tij, të hapur ose në heshtje.

¹ Udhëzues për nenin 3 të Konventës – Ndalimi i torturës, botim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përditësimi i fundit: 31.08.2022. fq.8.

Tortura është forma më e rëndë dhe e qëllimshme e trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues të personit të privuar nga liria. Jo çdo keqtrajtim mund të cilësohet torturë ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues. Dallimi mes tyre qëndron tek intensiteti dhe qëllimi që ndjek personi që e kryen aktin.

Torturë nënkupton çdo veprim me të cilin personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhimbje a vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me synim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë, informacione ose pohime për ta dënuar për veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e cilitdo lloji, kur dhimbjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij. Ky term nuk përfshin vuajtjet ose dhimbjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre.

Neni 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Trajtimi ose ndëshkimi çnjerëzor/poshtërues

Keqtrajtimi që nuk ka intensitet dhe/ose qëllim të mjaftueshëm për të qenë torturë mund të klasifikohet si trajtim çnjerëzor ose poshtërues. Neni 3 i KEDNJ mund të çenohet nga veprime ose me mosveprime me dashje, kur punonjësi në komisariatit e policisë, në institucionin e paraburgimit ose në burgje, ose një spital psikiatrik nuk përmbush detyrimet për të parandaluar situatat që mund të çojnë në keqtrajtim, ose personit të privuar nga liria nuk i sigurohen standardet e duhura të kujdesit si: kushtet e qëndrimit, të trajtimit, të kujdesit shëndetësor, etj

Mënyra, metoda, kohëzgjatja e efekteve fizike dhe mendore e keqtrajtimit, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës, mund të ndikojnë në përcaktimin e një veprimi si torturë ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues. KPT-ja sugjeron që pesha që i jepet këtyre faktorëve për të përcaktuar nëse akti mund të konsiderohet torturë duhet të jetë minimale. Rëndësi ka qëllimi dhe intensiteti i keqtrajtimit. Një veprim mund të konsiderohet poshtërues nëse kryhet në sytë e të tjerëve ose pa praninë e të tjerëve, pra në sytë e vetë personit. Ndonëse jo çdo keqtrajtim mund të cilësohet si torturë, ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues sipas nenit 3 të Konventës, ai mund të përbëjë shkelje të jetës private të personit të privuar nga liria dhe si e tillë është një sjellje e dënueshme.

Kush mund të jetë subjekt i veprave penale të torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues?

Tortura, trajtimi çnjerëzor ose poshtërues mund të kryhet nga personi që ushtron një funksion të caktuar në institucion ose nga persona të tretë, por me nxitjen ose pëlqimin e personit zyrtar. Për shembull, subjekte të veprave të tilla mund të jenë: një punonjës policie me ose pa uniformë në komisarjat; personeli i policisë në vendet e paraburgimit ose në burgje; personeli që ofron shërbime në institucion si personeli mjekësor; personi që merr në pyetje një person të arrestuar gjatë kohës së qëndrimit në komisarjatin e policisë ose në paraburgim ose në burg; personeli që merret drejtëpërdrejtë me të burgosurit dhe që mund të përdorë forcën fizike ose mjetet shtrënguese, etj. Subjekt të shkeljes së nenit 3 të Konventës mund të jenë edhe personat që kanë detyrimin të hetojnë në mënyrë efektive një rast kur pretendohet për torturë ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues. Pra, personi mban përgjegjësi jo për ushtrim të torturës, por për mos zbatimin e procedurave të hetimit efektiv të rastit të pretenduar si keqtrajtim. Shteti shqiptar është gjetur në shkelje të nenit 3 të Konventës nga GJEDNJ në rastet e mbajtjes së të burgosurve në kushte të këqija dhe kur ankesa ose kërkesa e personit të privuar nga liria nuk është hetuar ose është hetuar në mënyrë jo efektive.

Kush janë personat më të rrezikuar për të qenë viktimë të torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues?

Çdo person i privuar nga liria mund të jetë viktimë e torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues. Personat e ndaluar ose arrestuar në polici, të miturit, të huajt, personat që kanë kryer krime me rrezikshmëri të lartë shoqërore, personat e dënuar me dënime afatgjata ose me burgim të përjetshëm, personat me çrregullime të shëndetit mendor janë personat më të rrezikuar për të qenë viktimë. Raportet e KPT-së tregojnë se mundësitë më të mëdha për keqtrajtimin e një personi janë në komisarjatet e policisë, sesa në burgje. Kjo nuk do të thotë se në burgje nuk ka raste të torturës, trajtimit çnjerëzor, poshtërues ose degradues.

Raste ilustruese

1. Në një çështje, kërkuesi ishte sulmuar gjatë kohës së qëndrimit në burg. Raportet mjekësore dëshmonin numrin dhe ashpërsinë e goditjeve të marra. Personi kishte vijuar të qëndronte për një kohë në të njëjtën qeli me personat që e kishin sulmuar, ndërkohë që ishte transferuar me

vonesë në një burg tjetër, i ndodhur larg në vëndndodhje. Në spitalin ku ishte vizituar nuk ishte ekzaminuar dhe kuruar nga mjekë kirurgë, ndonëse kishte fraktura tepër të rënda. Gjykata vendosi se ka shkelje të nenit 3 të Konventës në formën e trajtimit çnjerëzor dhe degradues, nisur dhe nga fakti se autoritetet nuk kishin ndërmarrë një hetim efektiv dhe të hollësishëm në lidhje me pretendimet e bazuara të kërkuesit për keqtrajtim.²

2. Në një çështje tjetër, kërkuesi ishte një i mitur. Gjatë marrjes në pyetje nga një inspektor policie, ky i fundit e kishte goditur në organet gjenitale, si pasojë e së cilës i mituri kishte pësuar një frakturë të një tekstikuli dhe i ishte nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale. Kërkuesi ankohej për keqtrajtimin e kryer nga punonjësi i policisë. Gjykata në përfundim të shqyrtimit vlerësoi se aktet e kryera kishin qenë të një natyre që i shkaktonte kërkuesit dhimbje ose vuajtje fizike dhe mendore, duke mbajtur parasysh moshën e tij, krijonin ndjenjën e frikës, ankthit, inferioritetit që e përçmonin dhe e përulnin atë. Një trajtim i tillë kishte qenë çnjerëzor dhe degradues dhe se kishte shkelur nenin 3 të Konventës.³
3. GJEDNJ ka cilësuar trajtim poshtërues rastin kur një person i paraburgosur i ishte nënshkruar pa asnjë justifikim bindës kontrollit trupor duke e zhveshur vetëm me të brendshme, ndërkohë që rojet kanë bërë komente për trupin e tij. Gjykata konstatoi se sjellja që përçmonte dhe e përulte atë përbënte trajtim degradues, në shkelje të nenit 3 të Konventës.⁴

² Çështja Pantea kundër Rumanisë, kërkesa nr. 33343/96, 3 qershor 2003. Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, botim i Qendrës Evropiane, Këshilli i Europës & Komisioni European, 2005, fq. 159-164.

³ Çështja Rivas kundër Francës, kërkesa nr. 59584/00, 1 prill 2004. Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, vep.e cit. fq. 139-141.

⁴ Iwanzuk kundër Polonisë (kërkesa nr.25196/94). Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, vep. e cit, fq. 125-127.

II. Kushtet, trajtimi mjekësor në vendet e paraburgimit, burgje dhe parandalimi i torturës, trajtimin ose dënimit çnjerëzor ose degradues

Pse ka rëndësi momenti i pranimit në institucion?

Personat e paraburgosur dhe të dënuar (të burgosurit) duhet të trajtohen me dinjitet. Personi i paraburgosur prezumohet i pafajshëm, derisa gjykata të vendosë mbi fajësinë e tij me vendim të formës së prerë. Koha e qëndrimit në institucion duhet të jetë sa më e shkurtër dhe kohëzgjatja e paraburgimit verifikohet çdo 2 muaj. Prokurori informon gjykatën për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit/eve. Nëse prokurori nuk informon në kohë, gjykata verifikon nevojën e vijimit në masës së sigurisë vet ose me kërkesë të të pandehurit. Gjykata mund të vendosë vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, pra edhe të qëndrimit në paraburgim.

Pavarësisht kohës së qëndrimit, sistemimi i të burgosurit në institucion bazohet në vlerësimin e riskut, të gjendjes gjyqësore, problemeve ose konflikteve të mundshme të tij nëse ndan mjedisin e banimit me persona të tjerë. Komisioni i pranimit në institucion informon të burgosurin me një gjuhë të kuptueshme, për rregulloren e brendshme të institucionit, të drejtat dhe detyrimet, të drejtën për këshillim dhe ndihmë ligjore, rregullat e procedurat për paraqitjen e kërkesës dhe ankesës duke i vënë në dispozicion informacionin me shkrim.

GJEDNJ ka theksuar se ekzistenca e një dyshimi të fortë në lidhje me pjesëmarrjen e një personi në krime të rënda, ndonëse një element me rëndësi nuk mund të justifikojë në vetvete një kohë të gjatë paraburgimi⁵.

Kontrolli fizik dhe intim

Kontrolli fizik dhe intim kryhet vetëm kur ka dyshim të arsyeshëm se i burgosuri mund të ketë fshehur sende të ndaluara. Kontrolli intim kryhet vetëm nga personeli shëndetësor me të njëjtën gjini, duke respektuar në

⁵ Çështja Kalashnikov kundër Rusisë, kërkesa nr. 47095/99, 15 Korrik 2022. Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, vep.e cit, fq. 130-133.

çdo rast dinjitetin dhe integritetin e të burgosurit. Kontrolli fizik i grave të burgosura kryhet vetëm nga stafi me të njëjtën gjini, i trajnuar me metoda të përshtatshme kontrolli dhe në praninë e jo më pak se 2 (dy) punonjëseve femra, të cilat mbajnë procesverbal në lidhje me kontrollin e kryer. Kontrolli intim i të miturit bëhet me vendim të gjykatës, në prani të përfaqësuesit ligjor dhe detyrimisht të mbrojtësit ligjor të tij, nga mjekë të së njëjtës gjini ose të gjinisë së zgjedhur nga i mituri. Në raste urgjente, kontrolli mund të bëhet pa vendim gjykate. Përfaqësuesi ligjor mund të mos marrë pjesë nëse i mituri e dëshiron atë dhe ai zëvendësohet nga përfaqësuesi procedural. Shmangia nga këto rregulla mund të çojë në trajtime poshtëruese sipas nenit 3 të Konventës.

Kushtet materiale të jetesës

KPT-ja thekson krijimin e kushteve materiale për çdo të burgosur si parakusht për parandalimin e trajtimit degradues të të burgosurve. Mungesa e tyre dhe/ose e kombinuar me mbipopullimin, ajrosjen e pamjaftueshme në qelitë me disa të burgosur, mund të çojnë në trajtim degradues për të burgosurin. Kushtet e mbajtjes së të burgosurit, të kombinuara me moshën, nevojat individuale të tij, aftësinë e kufizuar, nëse ka, mund ta vendosë atë në kushtet e trajtimit çnjerëzor ose degradues. KPT-ja pranon se krijimi i kushteve normale të jetesës në institucionet e vuajtjes së dënimit mund të jetë shumë i kushtueshëm dhe se në shumë vende, përmirësimet kufizohen nga mungesa e fondeve. Ky problem mund të zbutet duke mbajtur parasysh që gjatë ndërtimit të burgjeve të reja ose rikonstruksionit të institucioneve ekzistuese të zgjerohen dritaret ose të hiqen pengesat në to, ose të merren masa që nuk pengojnë ajrimin ose ndriçimin natyral. Sipas KPT-së veprimtaritë jashtë qelive dhe shtimi i orëve të ajrimit ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës së të burgosurit.

Hapësira e jetesës dhe mbipopullimi

KPT-ja ka përcaktuar si standard minimal 6m² për një qeli për strehimin vetëm të një të burgosuri dhe 4m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në një qeli me strehim të më shumë se një të burgosur, pa përfshirë hapësirën e tualetit. Përsa i përket kubaturës së qelisë, ajo duhet të jetë jo më më pak se 9m². Niveli i mbipopullimit në burg ose në pjesë të veçanta të tij mund të çojë në trajtim çnjerëzor ose poshtërues të të burgosurit. KPT-ja dhe GJEDNJ nuk pranojnë justifikimin e kushteve të

papërshtatshme të mbajtjes së të burgosurit me mundësitë ekonomike të kufizuara, me mungesën e fondeve dhe të investimeve ose pamundësinë e respektimit të standardeve për shkak të mbipopullimit. Nga ana tjetër, KPT thekson se adresimi i mbipopullimit kërkon një qasje sistematike dhe përfshirje të shumë institucioneve.⁶

Kushtet higjienike

Institucionet duhet të sigurojnë kushtet normale për jetesë, mjedise të pajisura me pajisjet hidro-sanitare të nevojshme dhe ujë të rrjedhshëm të vendosura në mjedise të veçanta, të ndara nga mjediset e tjera ku zhvillohen veprimtari të përbashkëta. Mjetet e higjienës personale dhe të mjedisit sigurohen nga institucioni. Përdorimi i mjediseve sanitare duhet të respektojë privatësinë. Mungesa e kushteve higjienike ose të privatësisë mund të çojë në trajtim poshtërues ose degradues ose të dyja së bashku. KPT cilëson si trajtim degradues faktin nëse në një qeli nuk ka tualet, i burgosuri detyrohet të kryejë nevojat personale në shishe ose nuk ka akses sa herë që ka nevojë për të shkuar në tualet. Ligji kërkon që çdo qeli duhet të ketë të paktën një tualet dhe një lavaman dhe në qelitë ku janë vendosur më shumë se një i burgosur, ky mjedis duhet të jetë i ndarë nga pjesa tjetër e qelisë.

Ndriçimi dhe ajrimi

Ligji përcakton se i burgosuri vendoset në mjedise të pajisura me dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Krijimi i aksesit në dritën natyrore, zgjerimi i dritareve për futjen e ajrit dhe dritës natyrale është një standard që parandalon trajtimin degradues. KPT e ka adresuar këtë çështje për disa nga burgjet shqiptare. Standardet minimale ndërkombëtare përcaktojnë që drita artificiale duhet të sigurohet e mjaftueshme me qëllim që të burgosurit të lexojnë ose të punojnë pa dëmtime të shikimit. Reduktimi i ndriçimit gjatë natës në ambientet e banimit të të burgosurve është një çështje e adresuar nga KPT. KPT i ka kërkuar autoriteteve shqiptare që rregullat ekzistuese në lidhje me ndriçimin e qelive gjatë natës në burgje të rishikoheshin dhe të bëhet e mundur, të paktën, zbehja e ndriçimit artificial gjatë periudhave të gjumit. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve ka adresuar rekomandimin e KPT-së duke parashikuar që

⁶ Combating prison overcrowding, Extract from the 31st General Report of the CPT published on 21 April 2022, fq.4. Shih: <https://rm.coe.int/cpt-standard-combating-prison-overcrowding/1680a64461>.

“gjatë natës, ndriçimi i mjediseve të banimit të mbahet i fikur. Në rast se vlerësohet e nevojshme dhe e domosdoshme, drita e mjedisit mund të mbahet e ndezur ose me ndriçim të zbehur”.

Raste ilustruese

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit (Mekanizmi), gjatë monitorimeve të tij ka konstatuar situatën e lagështirës në disa dhoma në disa institucione të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka rekomanduar që të merren masa për eliminimin e plotë të lagështirës. Lidhur me mbipopullimin, Mekanizmi ka konstatuar mbipopullim në disa institucione që shoqërohej me fjetjen në tokë të personave, duke sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues, ... duke rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme për rishpërndarjen e të dënuarve në mënyrë proporcionale, duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar në sektorë të caktuar.⁷

GJEDNJ ka theksuar se mbipopullimi dhe mungesa e kushteve për të fjetur, e kombinuar me kohëzgjatjen e papërcaktuar të mbajtjes së personit, mund të çojë në një trajtim degradues.⁸

GJEDNJ ka vënë në dukje se mbipopullimi i qelisë, së bashku me mungesën e ajrimit të përshtatshëm, numri i tepërt i personave në qeli, mbushja e qelisë me parazitë, gjendja e shkatërruar dhe e papastër e qelisë dhe pjesës së tualetit, ndriçimi i vazhdueshëm i qelisë, mungesa e plotë e jetës private brenda qelisë çonin në trajtim degradues, dhe për pasojë ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.⁹

GJEDNJ ka theksuar se ndonëse nuk ka prova për ekzistencën e një synimi të qartë për të përlulur ose fyer kërkuesin, mungesa e një qëllimi të tillë nuk përjashton konstatimin se ka një shkelje të nenit 3 të Konventës. Personi ishte mbajtur në një qeli që nuk ajrohej dhe nuk kishte dritare dhe në periudha të caktuara bëhej aq nxehtë sa nuk durohej. Sipas gjykatës, përdorimi i tualetit në prani të një burgosuri tjetër, ul dinjitetin e personit dhe mund të sjellë gjendje ankthi dhe stresi. Kushte të tilla arrijnë deri në trajtim degradues.¹⁰

⁷ Raport i Avokatit të Popullit “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti Europian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Qershor 2022, fq. 14.

⁸ Çështja Dougoz kundër Greqisë, (kërkesa nr. 40907/98). Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, vep. e cit, fq. 119-122.

⁹ Çështja Kalashnikov kundër Rusisë, kërkesa nr. 47095/99, 15 Korrik 2022. Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, vep. e cit, fq. 130-133.

¹⁰ Çështja Peers kundër Greqisë, 2001. Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, vep. e cit. f.122-124.

Trajtim mjekësor i përshtatshëm sipas nevojave të të burgosurit

Institucioni detyrohet të sigurojë shërbimin e kujdesit shëndetësor 24 orësh, nën kujdesin e personelit shëndetësor të institucionit, të përshtatshëm sipas nevojave të çdo të burgosuri gjatë të gjithë kohës së qëndrimit të tij në institucion. Shërbimi ose trajtimi stomatologjik dhe farmaceutik në institucion i ofrohet çdo të burgosuri. Trajtimi mjekësor i përshtatshëm nënkupton përcaktimin e shpejtë dhe të saktë të diagnozës, të mjekimit, të ndjekjes sistematike të gjendjes, evidentimit të ecurisë së trajtimit në kartelën e të burgosurit, përcaktimin e trajtimit dhe terapive për rehabilitimin e gjendjes shëndetësore të tij. Nëse një trajtim i tillë nuk mundësohet në institucion, i burgosuri ka të drejtë të kryejë vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion shëndetësor brenda vendit jashtë sistemit të burgjeve. Gjithashtu, i burgosuri ka të drejtë të kryejë vizita mjekësore nga një mjek dhe/ose në një institucion shëndetësor brenda vendit, me kushtin që t'i mbulojë vetë shpenzimet mjekësore dhe çdo shpenzim tjetër, që rrjedh si pasojë e zgjedhjes së mjekut prej tij.

KPT-ja vlerëson standardet e trajtimit mjekësor të të burgosurit nga disa tregues si: aksesin e të burgosurit te një mjek; kujdesi shëndetësor me të njëjtën cilësi si jashtë institucionit; miratimi dhe konfidencialiteti i të burgosurit; kujdes shëndetësor parandalues; asistencë humanitare; pavarësia profesionale e stafit mjekësor dhe kompetenca profesionale¹¹. Mangësitë në përmbushjen e një ose më shumë standardeve janë gjetur nga GJEDNJ si trajtim degradues dhe shkelje e nenit 3 të Konventës.

Gjatë vizitave të kryera në Shqipëri, KPT-ja ka rekomanduar që të ndërmerren hapa nga ana e burgjeve për të garantuar ofrimin e çdo shërbimi të kujdesit shëndetësor, me pajisje të tilla të nevojshme për të shpëtuar jetë njerëzore. Gjithashtu, është sugjeruar marrja e masave për zëvendësimin e pajisjeve të vjetëruara.¹²

Ekzaminimet, diagnostikimi, parandalimi i sëmundjeve dhe kujdesi shëndetësor

Administrata e institucionit kujdeset për të burgosurit me sëmundje kronike dhe të moshuarit, ata që vuajnë nga sëmundjet seksualisht të

¹¹ Shërbimi i Kujdesit shëndetësor në burgje, pjesë nga raporti i 3-të i Përgjithshëm, KPT, Këshilli i Evropës, publikuar në vitin 1993, fq.1.

¹² Raport i Avokatit të Popullit "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti Europian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, vep.e cit., fq.34.

transmetueshme; sëmundjet e lindura të gjakut; çrregullimet e shëndetit mendor; çrregullimet post traumatike; ose që reflektojnë rrezikun e vetëvrasjes ose të vetëdëmtimit, duke mbajtur parasysh historinë e shëndetit riprodhues; praninë e varësisë së drogës; abuzimin seksual dhe format e tjera të dhunës, që mund të ketë pësuar përpara pranimit në institucion. Ekzaminimi, diagnostikimi dhe mjekimi i sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve të tjera sigurohen në kushtet e institucionit. Nëse nuk është e mundur, i burgosuri transferohet në qendrën spitalore të burgjeve dhe, kur është e nevojshme, në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë ose në institucionet spitalore rajonale civile.

Ligji parashikon izolimin mjekësor në mjedise të posaçme kur dyshohet se i burgosuri ka sëmundje ngjitëse. Trajtimi i tij bëhet sipas standardeve të njëjta me personat e të njëjtës kategori që trajtohen jashtë institucionit. Mjeku vendos për pushimin e izolimit kur nuk ekzistojnë më shkaqet që çuan në vendosjen e izolimit. Izolimi mjekësor mund të shkaktojë një trajtim degradues nëse nuk respektohen kriteret e parashikuara në ligj.

KPT-ja pranon se në një periudhë me vështirësi ekonomike – si ato që hasin shumë prej vendeve të vizituara nga KPT-ja – duhen bërë disa sakrifica, përfshirë dhe në institucionet e vuajtjes së dënimit. Por, cilatdo qofshin vështirësitë e hasura në një kohë të caktuar, fakti i privimit të një personi nga liria e tij nënkupton gjithmonë detyrimin e marrjes në ngarkim nga institucioni; ky detyrim kërkon metoda efikase parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi. Respektimi i këtij detyrimi nga autoritetet publike është akoma më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për trajtimin e sëmundjeve që rrezikojnë të jenë fatale.¹³

Ndërhyrjet mjekësore të nevojshme

Ligji parashikon se në rast të nevojës për ndërhyrje mjekësore, i burgosuri i nënshtrohet trajtimit shëndetësor, sipas standardeve të shërbimit jashtë institucionit. Në raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të burgosurit, ai transferohet për mjekim në qendrën spitalore të burgjeve ose në institucionet e kujdesit shëndetësor rajonal. Mosofrimi i trajtimit të përshtatshëm mjekësor mund të vëre në rrezik jetën e të burgosurit duke cënuar nenin 2 të KEDNJ “E drejta e jetës” dhe nenin 3 të Konventës “Ndalimi i torturës”.

¹³ Zhvillimet e standardeve të KPT-së gjatë burgosjes. Pjesë nga raporti i 11-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2001.

ÇËSHTJA GRORI k. SHQIPËRISË (Aplikim nr. 25336/04, 7 korrik 2009)

Gjykata vë re se provat nga burimet e ndryshme mjekësore konfirmojnë se ankuesi kishte probleme të shumta mjekësore që kërkonin ndihmë të rregullt mjekësore. Gjithsesi, asgjë nuk sugjeronte se sëmundjet e tij ishin në parim të papërputhshme me burgimin. Burgu kishte një njësi mjekësore, ku ankuesi ishte vizituar në shumë raste dhe sëmundja e tij prezumohet të mund të ishte trajtuar në atë njësi. ... Gjykata i referohet vëzhgimeve të saj se ankuesi nuk e kishte marrë ndihmën e nevojshme ligjore. Ndërsa ishte në spitalin e burgut, ai vuante qartë nga efektet fizike të kushteve mjekësore. Në lidhje me efektet mendore, ai mund të ketë ditur se ishte në rrezik të një emergjence mjekësore në çdo moment, emergjencë me pasoja serioze dhe se nuk kishte ndihmë të kualifikuar mjekësore të disponueshme. Ankuesit jo vetëm që iu refuzua ndihma e nevojshme mjekësore nga autoritetet, por ai u vendos në një regjim të sigurisë së lartë, duke iu mohuar mundësia për të kontaktuar me përfaqësuesin e tij. Kjo mund të ketë çuar në një ankth të konsiderueshëm. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e qeverisë se trajtimi i ankuesit me medikamentin *Interferon Beta* do të ngarkonte rëndë buxhetin e shtetit. Ndërsa gjykata nuk nënvlerëson vështirësitë financiare të qeverisë, ajo thekson se ky medikament ofrohet pa pagesë për publikun në spitale. Qeveria nuk dha asnjë arsye legjitime për të justifikuar heqjen e së drejtës së ankuesit, ndryshe nga shtetasit e tjerë në gjendje të lirë që trajtohen me këtë medikament, për të përmbushur plotësisht kostot e medikamenteve të tij nga shteti përkatës. ...Rreziku i sëmundjes, i shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatja e kohës së burgimit, e intensifikuan frikën e tij. Në këto rrethana, mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, që i shtohet refuzimit të autoriteteve për t'i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor të dhënë nga mjekët civil, krijuan një ndjenjë kaq të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në kuptimin e nenit 3. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë aspekt.

Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor

Sipas ligjit, personi për të cilin gjykata ka caktuar masën mjekësore “mjekim të detyruar” mbahet në insitucione mjekësore dhe jo në burg. Policia e Burgjeve ka vetëm përgjegjësinë e sigurimit të perimetrit të jashtëm të institucionit mjekësor. Personat me çrregullime të shëndetit mendor, por të përgjegjshëm duhen trajtuar nga mjeku specialist psikiatër

dhe nga ekipi multidisiplinar, në çdo kohë, pavarësisht nga regjimi i mbajtjes në institucion. Trajtimi i grave të burgosura me çrregullime të shëndetit mendor bëhet duke mbajtur parasysh nevojat që burojnë nga çrregullimi mendor dhe për shkak të gjinisë.

KPT-ja i ka rekomanduar autoriteteve shqiptare të rishikojnë burimet e personelit të kujdesit shëndetësor në të gjitha burgjet që kanë persona me probleme të shëndetit mendor.

Në çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë, GJEDNJ i kërkoj autoriteteve shqiptare se “duhet të marrin masat e nevojshme të një karakteri të përgjithshëm për të siguruar kushte të përshtatshme jetese dhe ofrimin e shërbimeve të duhura të kujdesit shëndetësor për personat e sëmurë mendorë që janë subjekt i heqjes së lirisë në bazë të një trajtimi mjekësor të detyrueshëm të urdhëruar nga gjykata” dhe se ata “duhet të krijojnë një “institucion të përshtatshëm” duke rinovuar objektet ekzistuese ose duke ndërtuar një objekt të ri të specializuar për strehimin e personave si aplikanti “me një qëndrim për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës”. ...Trajtimi farmakologjik duhet të kombinohet me forma të tjera të njohura të trajtimit terapeutik, si pjesë e një plani trajtimi të individualizuar për çdo individ. ... Autoritetet duhet të sigurojnë gjithashtu rekrutimin e një numri të mjaftueshëm punonjësish të kualifikuar të kujdesit për shëndetin mendor në objekte të tilla. Për më tepër, autoritetet duhet të marrin në konsideratë, sipas rastit, mundësinë e trajtimit ambulator të shëndetit mendor.”¹⁴

KPT ka konstatuar mungesë në mjekë dhe infermierë dhe ka rekomanduar që të ndërmerren hapa për të siguruar praninë e rregullt të një mjeku të përgjithshëm ku mungon ose për të rekrutuar të paktën një mjek të përgjithshëm me kohë të pjesshme dhe për të rritur personelin me infermierë në institucionin J.M. KPT kërkon përmirësim të vazhdueshëm në këtë fushë¹⁵.

Trajtimi mjekësor i pavullnetshëm

Ligji parashikon mundësinë e trajtimit mjekësor të pavullnetshëm në raste të caktuara si; i burgosuri ka çrregullime të shëndetit mendor dhe disa masa të kufizimit fizik të parashikuara nga ligji në fuqi për shëndetin mendor janë të nevojshme për të parandaluar që ai të mos

¹⁴ Çështja Strazimiri kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 34602/16, 21 Janar 2020.

¹⁵ Raporti për Qeverinë Shqiptare mbi vizitën e kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Çnjerëzore ose Trajtim ose Ndëshkim Degradues (CPT) nga data 20 deri më 30 nëntor 2018, fq.37.

dëmtojë veten ose të tjerët. Ligji ndalon eksperimentet shëndetësore që përfshijnë të burgosurit dhe që mund të shkaktojnë dëmtime fizike, çrregullime mendore ose dëmtime të tjera në kufizimin fizik të të sëmurit me çrregullime të shëndetit mendor si mjet ndëshkimi ose si mjet më lehtësues për stafin e shërbimit.

Masa të tilla si:

Mbajtja me forcë e personit ose përdorimi i detyruar të medikamenteve ose imobilizimi ose izolimi i personit me çrregullime të shëndetit mendor zbatohet për periudha të shkurtra kohore dhe sipas protokolleve të miratuara. Ato përdoren kur trajtimi mjekësor dhe masat e tjera nuk kanë dhënë rezultate dhe jeta e personit ose personave të tjerë vihet në rrezik. Procedurat e ndjekura për realizimin e kufizimit fizik dhe arsyet e përdorimit të tyre duhet të përshkruhen në mënyrë të hollësishme në kartelën e personit të sëmurë. GJEDNJ nuk i ka konsideruar masat terapeutike si trajtim çnjerëzor dhe degradues nëse provohet se ato kanë qenë të domosdoshme, nëse ka protokolle të miratuara dhe provohet se ato janë respektuar gjatë trajtimit të të burgosurit të sëmurë. Për këtë, kërkohet që çdo veprim dhe protokoll i ndjekur të jetë përshkruar dhe dokumentuar në mënyrë të detajuar.

Çështja Prizreni kundër Shqipërisë¹⁶

Gjykata në vendimin e saj thekson se kërkuesi pretendonte se ai e kishte gjetur vëllanë e tij në spital të lidhur me çarçafë, teksa ishte pa ndjenja dhe se shenjat në kyçet e duarve të vëllait të tij ngrinin dyshime serioze se ai kishte qenë i prangosur ndërsa ishte në spital. Gjithashtu, rezultati i ekzaminimit mjekoligjor, në të cilin tregohet një mungesë mjekimesh në gjak, ngrinte dyshime nëse ai kishte marrë kujdesin e duhur mjekësor. Në lidhje me këtë gjë nuk u bënë hetime të tjera, pavarësisht një nënvizimi në raportin e ekzaminimit mjekoligjor se çështja duhej të hetohej më tej. Gjykata ka konstatuar se autoritetet nuk kanë përcaktuar në mënyrë të prerë shkakun e vdekjes së SH.P. Gjithashtu, autoritetet nuk kanë dhënë një shpjegim të fortë në lidhje me dy të nxirat e gjetura në kyçet e duarve të SH.P. dhe se nuk ka asnjë tregues se policia e burgut ose personeli i spitalit janë marrë në pyetje në lidhje me këtë çështje. Deklaratat e kërkuesit për policinë, së bashku me gjetjet e raportit mjekoligjor për të nxirat e konstatuara në trupin e vëllait të tij, çojnë në pretendimin e diskutueshëm se vëllai i kërkuesit mund të ketë qenë subjekt i një trajtimi, i cili vjen në kundërshtim me nenin 3, gjatë kohës që

¹⁶ Çështja Prizreni kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 29309/16. Vendimi i datës 11.06.2019.

ishte në spital, duke nënvizuar kështu detyrimin e autoriteteve për të hetuar çështjen (*Bouyid kundër Belgjikës* [DHM ç, nr. 23380/09, § 92, GJEDNJ 2015]. Gjykata përsërit se prangosja nuk ngre domosdoshmërisht një problematikë, sipas nenit 3 të Konventës, për aq kohë sa masa është ushtruar në lidhje me ndalimin e ligjshëm dhe nuk përbën përdorim të forcës apo ekspozim publik, i cili tejkalon atë çfarë konsiderohet në mënyrë të arsyeshme si e nevojshme. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të merret në konsideratë, për shembull, nëse ka rrezik nëse personi në fjalë mund t'i fshihej drejtësisë ose të shkaktonte dëmtime ose dëme (shih *Tarariyeva kundër Rusisë*, nr. 4353/03, § 109, GJEDNJ 2006-XV (ekstrakte)....Në këtë mënyrë, gjykata konstaton se autoritetet vendese nuk kanë marrë mjaftueshëm masa hetimore për të përcaktuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse të nxirat në kyçet e duarve të vëllait të kërkuesit ishin shkaktuar nga trajtimi, i cili bie në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Në këto rrethana, gjykata e ka të pamundur të arrijë në përfundimin nëse ka pasur një shkelje të qartë të nenit 3. ... Në analizën përfundimtare, gjykata merr në konsideratë se autoritetet nuk kanë mundur të kryejnë një hetim efikas për të përcaktuar nëse vëllai i kërkuesit ka qenë subjekt i keqtrajtit teksa ishte i ndaluar. Në këtë mënyrë, në lidhje me këtë aspekt, ka pasur një shkelje të nenit 3 të Konventës, sipas aspektit të tij procedural.

Ushqyerja e të burgosurit me detyrim

I burgosuri gëzon të drejtën e grevës, madje edhe të urisë në institucion. Rufizimi për të marrë ushqim mund të vërë në rrezik jetën e tij. Ushqyerja me detyrim e të burgosurit që refuzon të marrë ushqim në mënyrë të vullnetshme (në grevë ose për shkak se është i sëmurë me çrregullime të shëndetit mendor) nuk konsiderohet trajtim çnjerëzor ose degradues nëse mosushqyerja vë në rrezik jetën e tij. Në raste të tilla, ka rëndësi që institucioni të ketë miratuar procedurat e nevojshme sipas standardeve, ato të jenë zbatuar me përpikmëri në rastet kur lind nevoja për ushqyerje me detyrim, personeli të ketë marrë më parë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ushqyerjen me detyrim dhe çdo veprim i kryer të jetë përshkruar me detaje në kartelë dhe të jenë të disponueshme në rast të nevojës për hetim. Ushqyerja me detyrim është e ndaluar dhe përbën shkelje të nenit 3 të Konventës nëse përdoret për të ndaluar një grevë ose protestë ndaj kushteve të mbajtjes ose trajtim të burg dhe nuk ka arsye mjekësore për t'u bërë.

Lirimi i personit të privuar nga liria për shkak të gjendjes shëndetësore

Ekzekutimi i vendimit me burgim mund të shtyhet gjer në shërimin e

tij në rast se i dënuari vuan nga një sëmundje që pengon ekzekutimin e vendimit. Gjykata ka të drejtë të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe të vërë në provë të dënuarin, bazuar në kriteret e përcaktuara në Kodin Penal.

Në rast pezullimi të ekzekutimit të vendimit për arsye moshe ose kushte shëndetësore ose mendore, i dënuari vihet në prove, në rastet kur jepet dënimi me burg deri në pesë vjet. I dënuari mban kontakte me shërbimin e provës dhe gjatë kohës së provës nuk duhet të kryejë vepër tjetër penale dhe duhet të përmbushë një ose më shumë detyrime të parashikuara në Kodin Penal. Vendimi merret nga gjykata bazuar në kërkesën e të dënuarit, të mbrojtësit ose të prokurorit. I dënuari mund të lirohet me kusht kur përmbushen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj.

Gjykata e vendit ku gjendet institucioni i ekzekutimit të vendimit ka të drejtë të lirojë të dënuarin dhe pjesën e mbetur të dënimit ta vuajë duke qëndruar në shtëpinë e tij, në një shtëpi tjetër private, në një qendër të kujdesit të shëndetit publik kur gjendja shëndetësore e tij kërkon kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor jashtë burgut. Gjykata mund të vendosë edhe lirimin me kusht kur plotësohen kriteret dhe kushtet ligjore të përcaktuara nga Kodi Penal.

Dënimi me burgim i mbetur mund të falet kur çmohet se dënimi i kryer ka arritur qëllimin edukues dhe riintegrues të të dënuarit dhe vuajtja e mëtejshme e dënimit bie ndesh me thelbin e drejtësisë. Ligji për faljen përcakton si kritere për faljen e dënimit, ndër të tjera edhe shkaku e sëmundjes ose moshën e personit të dënuar, të cilat justifikojnë ndërprerjen e vuajtjes së mëtejshme të dënimit. Kërkesa i drejtohet Presidentit të Republikës dhe depozitohet në Ministrinë e Drejtësisë. Presidenti i Republikës mund të bëjë falje të plotë ose të pjesshme ose zëvendësim të dënimit. Falja është një e drejtë, por jo detyrim për gjykatën. Falja nuk funksionon në rast se dënimi nuk ka marrë formë të prerë.

Raste ilustruese

Çështja Zaharia kundër Shqipërisë (Aplikim nr. 45022/16, 9 nëntor 2021)

Aplikanti pretendoi se autoritetet kishin dështuar t'i ofronin atij trajtim mjekësor të mjaftueshëm dhe të ekzekutonin vendimin e Gjykatës së Rrethit

Krujë në shkelle të nenit 3 dhe 6 të Konventës. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Krujë udhëzonte autoritetet që t'i ofronin aplikantit ndihmën e përshtatshme mjekësore dhe t'i jepnin fund këtij trajtimi çnjerëzor dhe degradues që lindte nga mungesa e kësaj ndihme. Pas dështimit të përpjekjeve për të arritur një zgjidhje miqësore, më 12 maj 2021, Gjykata mori një deklaratë të njëanshme nga Qeveria, sipas të cilës qeveria merr përsipër të zbatojë vendimin e Gjykatës së Rrethit Krujë ... Autoritetet, ... marrin përsipër t'ia nënshtrojnë aplikantin ekzaminimit nga një ekip mjekësh specialist, brenda tre muajsh nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës në këtë rast, me qëllim që (1) të vlerësohet gjendja aktuale shëndetësore e tij, dhe (2) të rekomandojnë, bazuar në dijet e tyre më të mira, ndërhyrjet kirurgjikale që mund të përmirësojnë gjendjen e tij shëndetësore. Në përputhje me ligjet dhe procedurat vendase, aplikantit do t'i ofrohet mundësia të caktojë mjekun e zgjedhur prej tij që të bëhet anëtar i ekipit mjekësor. Autoritetet marrin përsipër të informojnë aplikantin, pa vonesë, për ndonjë rekomandim dhe përfundime që mund të nxirren nga ekipi i mjekëve specialistë dhe t'i përgjigjen ndonjë pyetjeje të tij lidhur me rrugën e propozuar të veprimeve për t'i dhënë mundësinë atij që të marrë një vendim të mirëinformuar lidhur me ndërhyrjet më të përshtatshme. Autoritetet marrin përsipër t'i ofrojnë aplikantit çfarëdo terapish post-operative në përputhje me çfarëdo këshillash që mund të jepen nga mjekët specialistë me të njëjtat kushte si terapitë post-operative ofruar publikut të gjerë dhe që mbulohen nga sistemi shëndetësor publik shqiptar. Autoritetet marrin përsipër t'i sigurojnë aplikantit dhe përfaqësuesit të tij ligjor qasje në dosjen mjekësore në përputhje me ligjet dhe procedurat e vendit. Qeveria deklaron se është e përgatitur të paguajë 13,000 euro (trembëdhjetë mijë euro) për të mbuluar çfarëdo dëmsh pasurorë dhe jopasurorë, si dhe 2,000 euro (dy mijë euro) për të mbuluar të gjitha kostot dhe shpenzimet, plus ndonjë taksë që mund t'i imponohet aplikantit. Për këto arsye, Gjykata, unanimisht e hoqi çështjen nga lista dhe mbajti shënim kushtet e deklaratës së Qeverisë që është përgjigjur sipas Neneve 3 dhe 6 të Konventës dhe modalitetet për përmbushjen e angazhimeve të referuara aty.

Në një çështje tjetër, GJEDNJ ka analizuar regjimin e burgut për personat e sëmurë. Gjykata i kushtoi vëmendje faktit se kërkuesi ndonëse i sëmurë kishte qëndruar në qeli vetëm një ditë, pra për një kohë të shkurtër. Gjykata ishte e mendimit se nuk kishte të bënte më shkelle të nenit 3, pasi personi ishte mbajtur në atë qeli për një periudhë shumë të shkurtër.¹⁷ GJEDNJ shqyrtoi rastin e një kërkuese të sëmurë, e cila ishte mbajtur në komisarjat dhe në burg në rrethana kur institucioni nuk mund të përmbushte nevojat e veçanta të saj. Gjykata konsideroi se burgimi i një personi krejt të paafët në kushtet kur ajo ishte në të ftohtë, në mënyrë të rrezikshme për jetën e saj, për shkak se krevati i saj

¹⁷ GJEDNJ, Çështja Sakkopoulos kundër Greqisë, kërkesa nr. 61828/00, 15 janar 2004.

ishite tepër i fortë dhe i paarritshëm, fakti që ajo nuk ishte në gjendje të shkonte në tualet ose të pastrohej pa sakrificë të mëdha, përbënte trajtim degradues në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.¹⁸

Çështja Dybeku kundër Shqipërisë (Aplikim nr. 41153/06, 18 dhjetor 2007)

Prej vitit 1996 e më tej, ankuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake kronike. Për shumë vite ai ka marrë trajtim mjekësor si pacient në shumë spitale psikiatrike. Ankuesi u ankua që në burg kushtet e tij të vuajtjes së dënimit dhe trajtimi mjekësor që ka marrë ishin të papërshtatshme, referuar gjendjes së tij shëndetësore. Për më tepër, ai u ankua për shkelje të nenit 6 të Konventës, për arsye të parregullsisë së proceseve në lidhje me papërshtatshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit, referuar gjendjes së tij shëndetësore.

Gjykata vlerëson se ka patur shkelje të nenit 3 të Konventës duke pasur parasysh efektet në tërësi të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit, të cilave i ishte nënshtruar ankuesi, të cilat kishin pasur efekt të dëmshëm në shëndetin dhe mirëqenien e tij, konstatimet e KPT-së në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht, dhe precedentin e saj në këtë fushë, Gjykata konsideron se natyra, kohëzgjatja dhe vuajtja e dënimit sa i takon keqtrajtimin të cilit ankuesi i ishte nënshtruar, si dhe efektet që kanë pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'u kualifikuar si çnjerëzore dhe degraduese.

GJEDNJ ka konstatuar se mungesa e një mbikëqyrjeje dhe kujdesi ndaj gjendjes së një shtetasi dhe mungesa e këshillave të specializuara psikiatrike në lidhje me gjendjen dhe trajtimin e tij nxirrnin në pah mangësi domethënëse në lidhje me trajtimin mjekësor që duhet t'u ofrohet personave me sëmundje mendore dhe që mendohet se mund të kryejnë vetëvrasje. Dënimi i rëndë disiplinor ndaj këtij shtetasi mund të ketë cënuar qëndrueshmërinë e tij fizike dhe morale. Gjykata arriti në përfundimin se ky trajtim nuk është në përputhje me standardet e trajtimit të kërkuar për personat me meta mendore, për rrjedhojë ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.¹⁹

¹⁸ GJEDNJ, Çështja Price kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 33394/96, 10 korrik 2001.

¹⁹ GJEDNJ, Çështja Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 27229/95, 3 prill 2001.

III. Regjimi në institucion dhe ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues

Regjimi në institucion dhe zbatimi i tij

Institucionet kanë regjime të ndryshme. Vendosja e të burgosurit në regjim të sigurisë së lartë nuk përbën shkelje të Konventës, por të burgosurit duhet t'i respektohet dinjiteti njerëzor dhe mënyra e mbajtjes në regjim duhet të jetë e tillë që të mos krijojë stres dhe vuajtje të një intensiteti që kapërcen nivelin e pashmangshëm që shkakton kryerja e dënimit me burgim. Regjimi strikt për të burgosurit me rrezikshmëri të lartë shoqërore, i shoqëruar me kontrolle të shpeshta intime trupore që nuk justifikohet, dhe/ose në mungesë të veprimtarive të përbashkëta e rekreative jashtë qelisë përbëjnë shkelje të konventës.

Ligji parashikon vendosjen e të burgosurve në regjimin e posaçëm si për shembull regjimi 41 bis. Procedurat e pranimit dhe trajtimit të të burgosurit në këtë regjim bëhen sipas rregullave të përcaktuara në ligj dhe që duhen respektuar me përpikmëri, ndryshe mund të çojë në trajtim çnjerëzor ose degradues.

Mbikqyrja e veçantë

Ligji parashikon vendosjen e të burgosurit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë në mjediset e brendshme të institucionit për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj kur rrezikon sigurinë e personelit të institucionit, të vizitorëve, ose kur ka rrezik të dëmtojë veten ose të tjerët; të pengojë veprimtarinë e të burgosurve të tjerë nëpërmjet dhunës ose kërcënimeve; të detyrojë të burgosurit e tjerë që t'iu nënshtrohen ose të përfitojë prej tyre; pengon të burgosurit e tjerë të mos zbatojnë rregullat individualisht ose në grup ose nxit shkeljen e tyre. Mbikqyrja e veçantë nuk mund të kufizojë rregullat e parashikuara në ligj përsa i përket higjienës, shërbimit shëndetësor, veshjes, ushqimit, mbajtjes, blerjes dhe marrjes së ushqimeve ose objekteve të tjera të parashikuara nga rregullorja e institucionit, aksesit në shërbimin e bibliotekës, lirisë së shprehjes dhe besimit, përdorimit të sendeve personale të lejuara, ajrimin, takimet me mbrojtësin, takimet me anëtarët e familjes e të afërmit.

Duhet të dini se:

- I burgosuri nuk mund të qëndrojë në këtë regjim më shumë se 3 muaj.
- Vendimi merret nga drejtori i institucionit, pasi lëshohet raporti i vlerësimit nga Komisioni i vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve.
- Në këtë regjim nuk mund të vendosen i burgosuri i mitur dhe gratë e burgosura.

Transferimi i vazhdueshëm i të burgosurit problematik nga një burg në tjetrin mund të ketë efekte të dëmshme në mirëqenien e tij psikologjike, fizike dhe vështirëson mbajtjen e kontakteve të përshtatshme me familjen dhe avokatën e tij. KPT-ja ka vënë në dukje se transferimet e njëpasnjëshme në rrethana të caktuara mund të arrijnë në trajtim poshtërues e çnjerëzor.²⁰

Përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik

Forca përdoret si mjete i fundit kur ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj. Masa e forcës së përdorur duhet të jetë në minimumin e mundshëm, përdoret për një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Përdorimi jo i domosdoshëm i forcës ose tejkalimi i përdorimit të saj mund të vlerësohen si keqtrajtim në formën e torturës ose të trajtimit çnjerëzor. Dallimi mes përdorimit të nevojshëm dhe proporcional të forcës dhe keqtrajtimit është i nevojshëm të bëhet në çdo rast kur është përdorur forca.

Mjetet e shtrëngimit fizik përdoren në mënyrë të përshkallëzuar, në proporcion me situatën, nivelin e rrezikut dhe duhet të jenë të kufizuara në kohë. Përdorimi i tyre për një periudhë më të gjatë se 48 orë, bëhet me miratimin e prokurorit. Gjatë përdorimit të mjeteve të shtrëngimit fizik, i burgosuri duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor. Ndalohet përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik si ndëshkim. Mosrespektimi i këtyre kriterëve mund ta vërë personelin që ushtron forcën ose përdor mjetet e kufizimit fizik, në kushtet e shkeljes së nenit 3 të Konventës.

Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata e Strasburgut ka pranuar se aspektet e integritetit moral dhe fizik të një personi, si pjesë e konceptit të jetës private sipas nenit 8 të Konventës, shtrihen në situata të privimit të lirisë, duke përfshirë përdorimin e masave të kufizimit. Megjithatë, përdorimi i

²⁰ Burgosja, Pjesë nga raporti i 2-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 1992, KPT, fq.4. Shih: <https://rm.coe.int/16806ce94e>.

masave të kufizimit si pranga duhet të ndikojë fizikisht ose mendërisht një të burgosur ose duhet të synojë ta poshtërojë atë në mënyrë që të lindë një çështje sipas nenit 8. (Çështja Raninen kundër Finlandës, 1997, §§ 63-64). Gjithashtu, Gjykata ka konstatuar, për shembull, se nuk ekzistonte asnjë justifikim për përdorimin e prangave ndaj një të burgosuri të sëmurë mendor për një periudhë prej shtatë ditësh gjatë gjithë kohës, pa asnjë mendim të specializuar psikiatrik. (Çështja Kucheruk kundër Ukrainës, 2007, §§ 140-146). Nuk është e justifikueshme asnjë përdorim prangosje e detyrueshme gjatë ushqyerjes me forcë e të burgosurit, pavarësisht nga çdo rezistencë (Çështjet Nevmerzhtsky kundër Ukrainës, 2005, § 97; Ciorap kundër Moldavisë, 2007, § 85). Është absolutisht e ndaluar nga ana e Gjykatës, përdorimi i prangave ndaj një shtetasi të burgosur të sëmurë, ndërkohë që pret për t'iu nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale, ose ndaj një të burgosuri të diagnostikuar me kancer e që dërgjet në shtratin e spitalit (Çështja Henaf kundër Francës, 2003, §§ 52-60; Istratii dhe të tjerë kundër Moldavisë, 2007, §§ 55-58, Okhrimenko kundër Ukrainës, 2009, § 98).

Duhet të theksohet gjithashtu se Gjykata ka konstatuar se mbajtja e një personi në një kafaz metalik gjatë një gjyqi – duke pasur parasysh natyrën e tij objektivisht degraduese, e cila është e papajtueshme me standardet e sjelljes së civilizuar që janë shenjë dalluese e një shoqërie demokratike – përbën në vetvete një fyerje ndaj dinjitetit njerëzor në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. (Çështjet Svinarenko dhe Slyadnev kundër Rusisë [GC], 2014, § 138; Korban kundër Ukrainës, 2019, § 134).

Cili janë garancitë që duhen të respektohen në rast të përdorimit të forcës?

Ligji parashikon disa garanci që duhen respektuar në rastet kur është përdorur forca:

- I burgosuri duhet t'i nënshtrohet ekzaminimit mjekësor të menjëhershëm;
- Në rast të dëmtimit fizik, të burgosurit i jepet menjëherë ndihma mjekësore, e cila pasqyrohet në kartelën shëndetësore;
- Njoftimi i drejtorit të institucionit, me shkrim dhe në mënyrë të menjëhershme;
- Hartimi i një raporti të detajuar dhe të besueshëm që duhet të përshkruajë arsyet, faktet dhe rrethanat që kanë diktuar nevojën e përdorimit të forcës, në ç'masë dhe me cilat mjete është ushtruar

forca, si dhe nëse ka shkaktuar ose jo lëndime fizike tek i burgosuri ose tek personeli i burgjeve;

- Në rast se i burgosuri pretendon se shenjat në trupin e tij janë pasojë e përdorimit të forcës ose mjeteve të përdorura, detyrimi për të provuar se nuk ka shkelje të ligjit i përket autoritetit që duhet të provojë se ai ka respektuar kriteret dhe procedurën ligjore për përdorimin e forcës;
- Raporti i hartuar analizohet me detaje dhe verifikohet në të gjithë elementët e tij;
- Mbajtja e një evidence për çdo rast të përdorimit të forcës kundër të burgosurve.

Mosrespektimi i këtyre rregullave mund të krijojë situata ku mund të të përballeni me keqtrajtimin e të burgosurve.

Duhet të dini se:

Ndalohet përdorimi i forcës kundër të miturit, përveçse si mjet i fundit për vetmbrojtje ose të rrezikut të drejtëpërdrejtë të vetëdëmtimit ose dëmtimit të të tjerëve.

Është absolutisht i ndaluar përdorimi i prangave ose këmishave të forcës, me përjashtim të rasteve kur forma të tjera të përdorimit të forcës më pak intensive kanë dështuar. Prangat mund të përdoren kundrejt zbatimit të izolimit dhe nevojës së tij, pasi izolimi mund të ketë pasojë shumë të dëmshme për të burgosurin, dhe në disa rrethana, mund të arrijë në trajtim poshtërues e çnjerëzor; në çdo rast, të gjitha format e izolimit të vetmuar duhet të jenë të përdorura në një kohë sa më të shkurtër. Ligji lejon përdorimin e prangave ose të mjeteve të tjera shtrënguese në lëvizjet në grup të të dënuarve. Mjetet shtrënguese që përdoren gjatë lëvizjes së të burgosurit duhet të jenë në proporcion me nivelin e rrezikut dhe qëllimin për të cilin përdoren. Prangat nuk lejohen të përdoren gjatë procesit gjyqësor ose në mjediset spitalore. GJEDNJ ka nënvizuar se KPT në rastin e vizitës në Francë kishte rekomanduar që praktika e lidhjes për arsye sigurie të të burgosurve në shtretërit e spitaleve ku ata mjekoheshin ishte e paligjshme.²¹

²¹ Çështja Henaf kundër Francës, (kërkesa nr. 5436/01). Shih: Bianku, L.: Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, vep. e cit, fq. 128-129.

Caktimi i masave disiplinore nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor

Ndërmjetësimi për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet të burgosurve ose mes tyre dhe personelit të institucionit duhet të jenë mundësia e parë, kur një gjë e tillë është e mundur. Masa disiplinore është forma e fundit e rregullimit të sjelljes së të burgosurit. Ato caktohen në përputhje me llojin, rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të burgosurit ndaj saj, moshën, personalitetin e tij, gjendjen fizike ose psikologjike të të burgosurit, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor gjatë së cilës i burgosuri dëgjohet dhe verifikohen pretendimet e tij. I burgosuri ka të drejtë të njihet me çdo akt të prodhuar gjatë procesit disiplinor. Nënshkrimi dhe vendosja e datës së nënshkrimit nga i burgosuri përbëjnë elementë përcaktues dhe provues të procesit të njoftimit të tij. Në rast kundërshtimi ose refuzimi të të burgosurit për t'u shprehur përpara komisionit disiplinor, ky fakt vërtetohet kundërt nënshkrimit të dy personave të tjerë nga personeli i institucionit, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shërbyer si shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

Ankimi ndaj masave disiplinore trajtohet nga Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit për dhënien e masës disiplinore. I burgosuri ka të drejtë të përfaqësohet nga mbrojtësi i tij ligjor në çdo fazë të shqyrtimit të ankimit. I burgosuri njoftohet me shkrim për vendimin, të drejtën dhe mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij, për paraqitjen e ankimit në gjykatë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Masat disiplinore dhe kategoritë e veçanta

Zbatimi i disa masave disiplinore si përjashtimi nga veprimtari të përbashkëta dhe përjashtimi nga ajrosja në grup mund të çojnë në trajtim çnjerëzor ose degradues të të burgosurit. Për këtë arsye, masa e përjashtimit nga veprimtari të përbashkëta nuk zbatohet, nëse nuk ka një raport paraprak të lëshuar nga mjeku, që vërteton gjendjen fizike dhe mendore të të burgosurit. Në rast zbatimi, i burgosuri i nënshtrohet kontrollit të përditshëm mjekësor. Këto masa nuk mund të jepen ndaj të burgosurve me aftësi ndryshe fizike ose çrregullime të shëndetit mendor, nëse ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes së tyre shëndetësore. Kohëzgjatja

e masave disiplinore të parashikuara në ligj përgjysmohet nëse është në interes të të burgosurit dhe në funksion të qëllimit rehabilitues.

Vendosja e të burgosurit në dhomat e veçimit në rastet e caktimit të masës së përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta duhet të respektojë standardet minimale që zbatohen për qëndrimin e të dënuarve, deri në përfundim të kohëzgjatjes së masës disiplinore. Gjatë kësaj periudhe, i burgosuri ka të drejtë të kontaktojë të paktën një herë me familjarët dhe të paktën një orë në ditë të dalë në ajrim (kur e lejojnë kushtet atmosferike). Ligji parashikon se masat për përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ose 14 ditë, zbatohen pas kalimit të afatit ligjor brenda të cilit i burgosuri ka të drejtë të ankimojë vendimin ose pas lënies në fuqi nga Komisioni i Apelimit.

Duhet të dini se:

- Ndaj të burgosurave shtatzëna ose që kanë fëmijë nën përkuqdesje në institucion zbatohet vetëm masa e këshillimit individual.
- Përjashtimi nga veprimtaritë e përbashkëta dhe ajrimi në grup deri në 10 ditë jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar nga ligji për të burgosurat.
- I burgosuri që ka pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose abuzim seksual gëzon një trajtim të kujdesshëm në rastet kur kryen shkelje të rregullave disiplinore. Masat disiplinore përdoren në mënyrë të përshkallëzuar, duke filluar me këshillim individual dhe paralajmërim për masat që mund të merren në vijim. Nëse i burgosuri përsërit shkeljen disiplinore brenda një periudhe tre mujore, zbatohen masat disiplinore të parashikuara në ligj, për aq kohë sa i shërbejnë qëllimit të tyre rehabilitues. Në çdo rast merret mendimi me shkrim i punonjësit të shërbimit social në institucion.
- Ndaj të miturit masat disiplinore përdoren si zgjedhje e fundit. Ato janë: vërejtje në formë paralajmërimi; kufizimi deri në 1 muaj i së drejtës për të përdorur sende të lejuara, me përjashtim të ushqimeve dhe mjekimeve të dhëna nga mjeku; kufizim i së drejtës për të përdorur dyqanin e ndodhur në mjedisin e institucionit për të mitur deri në 1 muaj, me përjashtim të atyre artikujve që garantojnë të drejtat për higjienë dhe ushqim të mjaftueshëm; kufizimi deri në një muaj i së drejtës për të marrë pako.

IV. Masat parandaluese dhe mekanizmat mbrojtës kundër torturës, trajtimit ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese

Cilat janë detyrimet e shtetit për parandalimin e torturës trajtimit ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese?

Shteti ka detyrime pozitive dhe negative. Shteti ka detyrimet pozitive si:

- t'u sigurojë të bugosurve respektimin e të drejtave dhe t'i mbrojë ata nga çdo formë trajtimi ose dënimi çnjerëzor, poshtërues ose degradues nga personeli i institucionit ose të burgosurit e tjerë;
- të sigurojë integritetin dhe mirëqënien e çdo të burgosuri;
- të marrë masa parandaluese si: e drejta për informim të të afërmeve, e drejta e mbrojtjes, e drejta për t'u kontrolluar nga një mjek i zgjedhur nga i burgosuri;
- të marrë masa mbrojtëse në rastet e keqtrajtimit si parashikimi i të drejtës së ankesës, ekzaminimi nga një mjek i pavaruar, evidentimi i shenjave, fotografikimi i tyre, hartimi i raportit të detajuar, të besueshëm dhe të pavaruar, mbrojtja e viktimës së keqtrajtimit dhe dëmshpërblimi i tij për dëmin e shkaktuar. Mjekët ligjor duhet të jenë të pavaruar dhe të specializuar në fushën përkatëse;
- të mundësojë një hetim të menjëhershëm, të plotë dhe efektiv në rast se një i burgosur pretendon se është keqtrajtuar; hetimi duhet verifikojë pretendimet, të zbulojë autorin dhe ta ndëshkojë atë;

Shteti ka detyrim negativ që të ndalojë çdo formë të keqtrajtimit, qoftë ai në formën e torturës ose trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues. Çdo dëmtim i shkaktuar gjatë qëndrimit në institucion i ngarkohet shtetit, me përjashtim të rasteve kur shteti jep shpjegime të pranueshme që hedhin poshtë këtë prezumim.

Pse janë të nevojshme masat parandaluese?

Gjatë një pjese të ditës, veprimet e personelit të burgjeve, veçanërisht ato në institucione me regjime të mbyllura janë jashtë vëmendjes dhe

vëzhgimit të personave që kanë përgjegjësi për të inspektuar dhe/ose monitoruar trajtimin dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të burgosurve brenda në institucion.

Cilat janë garancitë për parandalimin e keqtrajtimit të një personi të privuar?

KPT-ja ka përcaktuar garancitë procedurale standarde që duhet të përmbushen për të parandaluar torturën, ose trajtimin apo dënimin çnjerëzor ose poshtërues, të cilat janë:

a) Njoftimi i të afërmeve për ndalimin, arrestimin, vendndodhjen në paraburgim ose në burg

Personi që shoqërohet për në polici ose në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ka të drejtë të njoftojë të afërmit e tij menjëherë, me përjashtim të rastit kur i burgosuri i rritur nuk dëshiron t'i informojë ata. Kur personi është i mitur njoftohen menjëherë prindërit, kujdestari ligjor, ose nëse ata nuk gjenden ose nuk kanë lidhje me të miturit, ose janë akuzuar për një vepër penale sikurse i mituri, njoftohet Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës pranë Bashkisë. Njoftimi është i detyrueshëm. Të miturit i caktohet një përfaqësues procedural, nga lista e vënë në dispozicion nga njësia e mbrojtjes së fëmijës. Për shtetasit e huaj njoftohet përfaqësia konsullore, ose në mungesë të saj një nga përfaqësitë konsullore të shtetit që mund të mbrojnë të dënuarin e huaj. Nëse nuk ka një të tillë, njoftohen organizatat që punojnë në fushën e të drejtave për të huajt ose personat pa shtetësi.

b) E drejta për të pasur një mbrojtës të zgjedhur vetë, nga familjarët e tij ose të garantuar nga shteti

E drejta e personit për të marrë një avokat që në momentet e para të kufizimit të lirisë është garanci themelore parandaluese kundrejt keqtrajtimit. Personi që nuk ka mundësi ekonomike, ka të drejtë të përfitojë mbrojtje ligjore falas të garantuar nga shteti. Nëse personi është i mitur, mbrojtja juridike dhe psikologjike është gjithnjë falas. KPT-ja ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se periudha pas heqjes së lirisë është koha kur ndodhin raste të keqtrajtimit. Nëse dhuna ka ndodhur në momentin e transferimit për në komisariat ose në institucion, avokati ka të gjitha mundësitë për të ndërmarrë veprimet e duhura.

c) Informimi i personit për të drejtat dhe mundësitë e rivendosjes së të drejtave të cënuara

Personi duhet të informohet dhe të pajiset me kartën e të drejtave që në momentet e para të ndalimit ose arrestimit. Informimi bëhet me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme nga çdo person, duke mbajtur parasysh edhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara ose që nuk kuptojnë gjuhën shqipe. E drejta e personit për të heshtur dhe të mos flasë, përveç të dhënave si: emri, mbiemri dhe vendbanimi nuk mund të penalizojë personin e privuar nga liria.

d) E drejta për kërkuar një ekzaminim mjekësor nga një mjek i zgjedhur

Ligji parashkon të drejtën e kontrollit mjekësor nga mjeku në momentet e pranimit në institucion dhe evidentimin e çdo shenje ose gjurme që mund të përbëjnë të dhëna se personi është keqtrajtuar. Në praktikë, kjo e drejtë nuk garantohet në komisiariatet e policisë, ndërsa në vendet e paraburgimit dhe burgje, stafi mjekësor është pjesë e komisionit të pranimit në institucionin. Duke qenë se mjeku i institucionit mund të paragjykohe, KPT-ja thekson të drejtën e një kontrolli mjekësor të dytë nga një mjek i pavaruar dhe i zgjedhur nga personi i privuar nga liria.

Pse ka rëndësi evidentimi i shenjave të keqtrajtimit të personit të privuar nga liria?

Në momentin e pranimit në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut dhe psikologut. Nëse gjatë vizitës konstatohet ndonjë shenjë ose dëmtim fizik, ato regjistrohen në një regjistër të veçantë, së bashku me spjegimet rreth rrethanave ku janë shkaktuar si dhe njoftohet drejtuesi i institucionit brenda dy orëve nga konstatimi. Institucioni duhet të hartojë një raport të detajuar dhe të sqarojë arsyet e shkaktimit të shenjave. Raporti duhet të jetë i besueshëm dhe lehtësisht i verifikueshëm. Një kopje e raportit vendoset në kartelën mjekësore të të burgosurit të sapoardhur. I burgosuri ka të drejtë t'i kërkojë mjekut të institucionit ta pajisë me një raport mjekësor.

Në rast se konstatohen shenja në trup ose i burgosuri tregon shenja të plagëve dhe pretendon se ato janë të shkaktuara nga keqtrajtimi ose ai paraqet një gjendje shëndetësore jo të mirë, institucioni ka detyrimin të

provojë që shenjat, dëmtimet ose simptomat që shfaq personi nuk janë shkaktuar gjatë periudhës kur ai është ndaluar, arrestuar në flagrancë, shoqëruar për në komisarjat ose gjatë pranimit ose qëndrimit në institucion. Nëse ka të dhëna dhe fakte që krijojnë bindjen e arsyeshme se ndaj të burgosurit mund të jetë kryer vepër penale, njoftohen organet e procedimit penal.

Mekanizmi i kërkesë/ankesës brenda dhe jashtë institucionit

I burgosuri që pretendon se është keqtrajtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesë/ankesë së pari te personeli i institucionit si dhe pranë çdo institucioni tjetër si: drejtuesi i institucionit, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, Avokati i Popullit, Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, pranë Ministrisë së Drejtësisë, dhe organizatat e të drejtave të njeriut. Kërkesa ose ankesa regjistrohet në një regjistër të veçantë që mbahet dhe përditësohet në institucion, ndërsa personi ka të drejtë të marrë përgjigje për kërkesën brenda afatit të caktuar. Shterimi i rrugëve të brendshme të ankimit është një nga kushtet që kërkon Konventa para se personi t'i drejtohet GJEDNJ.

Përgjegjësitë e personelit të shërbimit të burgjeve për të raportuar rastet e keqtrajtimit

Qëllimi i nenit 3 të Konventës konsiston në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik të personit të privuar nga liria, nga veprimet e personelit dhe të burgosurve të tjerë. Veprimet që kryejnë personeli i institucioni varen nga përgjegjësitë që secili punonjës ka në institucion. Për shembull, sikurse është thënë më lart, komisioni i pranimit evidenton shenjat, stafi shëndetësor kqyr shenjat dhe harton raportin si dhe pajis me një kopje të tij të burgosurin. Personeli i kujdesit shëndetësor pas hartimit të raportit vë në dijeni drejtuesin e institucionit jo më vonë se 2 orë. Në përputhje me nenin 282 të Kodit të Procedurës Penale, personeli mjekësor ka detyrimin ligjor për të kallëzuar brenda 48 orëve, rastin pranë prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore.

Cilat janë detyrimet pozitive të institucionit në rast se pretendohet për një rast keqtrajtimi?

Institucioni ku pretendohet ose ka ndodhur keqtrajtimi i të burgosurit detyrohet të kryejë menjëherë hetime të gjithanshme, të shpejta, objektive, efektive, me standarde, të pavaruara dhe të paanshme me qëllim për të

hetuar çfarë ka ndodhur, për të identifikuar dhe vënë para përgjegjësisë personin/at përgjegjës, nëse vërtetohet keqtrajtimi.

A ka të drejtë i burgosuri të ankohet për mungesë të hetimeve efektive?

Po. GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 3 të Konventës jo vetëm në rastet kur është ushtruar torturë ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues, por edhe në rastet kur institucionet përgjegjëse nuk kanë kryer hetime ose hetimet nuk kanë qenë efektive. Dështimi i hetimeve për të provuar akuzën ose hetimi me standarde të munguara mund të cilësohet si një shkelje e nenit 3 të Konventës. Dështimi për të pasur hetime efektive është kur procedurat ose veprimet që duhet të kryen nuk janë respektuar, për shembull, i burgosuri nuk është dëgjuar, i është mohuar e drejta e mbrojtjes, ndonëse keqtrajtimi ka ndodhur në institucion, personi përgjegjës nuk është dënuar. GJEDNJ në shumë vendime të saj ka gjetur shkelje të nenit 3 të Konventës për arsye se nuk janë ndjekur procedurat për hetimin efektiv të një rasti të pretenduar si keqtrajtim ose ligji ka mangësi dhe nuk garanton mbrojtje dhe mjete efektive në raste të tilla.

V. Mekanizmat mbrojtës institucional për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimeve

Inspektimet e brendshme dhe monitorimet

Kontrolli i brendshëm ushtrohet nga drejtuesi i institucionit dhe organet eprorë. Personeli përkatës i sigurisë kryen verifikimet përkatëse. Për konstatimet që dalin nga verifikimet, personeli i institucionit merr masat përkatëse, ose në të kundërt kërkon ndërhyrjen e prokurorit dhe, kur është rasti, nëpërmjet tij kërkohej shqyrtimi i çështjes nga gjykata.

Ligji parashikon inspektimin në ambientet e IEVP-ve nga institucionet shtetërore si: Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me qëllim vlerësimin e respektimit të ligjit lidhur me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve. Në përfundim të inspektimit, grupi i punës përgatit rekomandimet, sipas rastit, për Ministrin e Drejtësisë, Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, ose Drejtorin e Institucionit, për marrjen e masave të nevojshme për shkeljet e konstatuara. Ligji parashikon monitorimin e të drejtave të të burgosurve nga institucione e organizma të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare, në kuadër të parashikimeve konventore ose marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Pranë Avokatit të Popullit është krijuar Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues i cili mbikqyr zbatimin e ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve. Mekanizmi vëzhgon rregullisht trajtimin e të burgosurve dhe paraqet rekomandime me qëllim që të përmirësohen kushtet dhe trajtimi i të burgosurve në institucion dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues. Mekanizmi pranon kërkesa ose ankesa nga të burgosurit, ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe organizatat të cilat e ushtrojnë këtë të drejtë, pasi të jetë dhënë pëlqimi paraprak nga ana e të burgosurit; marrin informacione, ankesa ose kërkesa të të burgosurit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit, ose të organeve shtetërore, ose organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë kontrolluar ose vizituar institucionin, si

dhe nga mbrojtësi i të burgosurit; kërkon informacione nga personeli i institucionit; verifikon dokumente, objekte, pajisje ose mjedise, që kanë lidhje me të burgosurin, brenda dhe jashtë institucionit. Komunikimi i të burgosurit me mekanizimin është konfidencial.

Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Komisioni është organ këshillimor pranë Ministrisë të Drejtësisë. Komisioni ose anëtarë i autorizuar prej tij ka të drejtë të kryejë verifikime në institucionet e dënimit mbi bazën e ankesave ose njoftimeve të paraqitura, pa paralajmërim, të marrë takim në çdo kohë me të burgosur të veçantë, të kërkojë sqarime dhe të këqyrë dokumentat dhe mjediset, si dhe të bëjë verifikimet e tjera të nevojshme. Në rastet kur konstaton shkelje, Komisioni rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e ligjit ose të së drejtës së shkelur; i parashtron Ministrisë të Drejtësisë konstatimet, duke i kërkuar marrjen e masave përkatëse. Ministri i Drejtësisë duhet të kthejë përgjigje për masat e marra brenda 30 ditëve. Kur marrja e masave është në kompetencë të prokurorit dhe gjykatës, Ministri i Drejtësisë i paraqet materialet prokurorit kompetent. Kur nga konstatimet çmohet se ka vend për ndryshime, shpesh ose për akte të reja ligjore e nënligjore, Komisioni i bën propozimet përkatëse Ministrisë të Drejtësisë.

Monitorimi nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatat vendase të të drejtave të njeriut

Institucionet mund të vizitohen pa autorizim nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zëvendëskryetari i Kuvendit, zëvendëskryeministri, Ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, deputetët, zëvendësministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit të ekzekutimit të vendimeve penale, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, mbrojtësit e të burgosurve, si dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të deleguar.

Organizatat e pavaruara të të drejtave të njeriut si për shembull, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ose mekanizma ndërkombëtare si Komiteti Evropian

për Parandalimin e Torturës gëzojnë të drejtën të vizitojnë institucionet dhe të monitorojnë kushtet e mbajtjes dhe trajtimit të të burgosurve.

Mekanizmat parlamentarë

Parlamenti miraton një ligj të ri ose përmirëson ligjet me qëllim trajtimin më të mirë të të burgosurve. Në kuadër të kontrollit parlamentar, komisionet dhe nënkomisionet parlamentare, për shembull Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ose Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut monitorojnë respektimin e të drejtave të të burgosurve duke vizituar institucionet ose mes shqyrtimit të raporteve vjetore dhe raporteve të posaçme të Avokatit të Popullit dhe të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Kryetari i Parlamentit ose deputetët kanë të drejtë të vizitojnë, pa autorizim, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Parlamenti miraton buxhetin e nevojshëm për përmirësimin e infrastrukturës së burgjeve dhe zgjerimin e programeve të ndryshme për rehabilitimin, riintegrimin dhe trajtimin më të mirë të personave të privuar nga liria.

Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT)

KPT ose siç njihet ndryshe CPT (*në anglisht*) është Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues, i krijuar nga Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve çnjerëzore ose degraduese. KPT me anë të vizitave që kryen vlerëson trajtimin e personave të privuar nga liria, me qëllim që të përforcojë në rast se është e nevojshme, mbrojtjen e tyre kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese. KPT pasi njofton autoritetet për vizitën që do të kryejë, ka të drejtë të vizitojë çdo institucion dhe të takojë pa njoftim çdo të burgosur që ndodhet në institucion ose persona të tjerë, liria e të cilëve është e privuar. KPT kryen vizita në komisiariatet e policisë, vendet e paraburgimit, burgje, qendrat e ndalimit të emigrantëve, spitalet psikiatrike, shtëpitë e kujdesit social etj., dhe vlerëson trajtimin e personave që janë vendosur në këto institucione. Në përfundim të vizitës KPT harton një raport që përmban gjetjet dhe rekomandime për institucionet dhe Qeverinë Shqiptare.

Monitorime nga organizata të tjera ndërkombëtare

Organizata ndërkombëtare të tjera mund të vizitojnë dhe monitorojnë institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe/ose vlerësojnë

trajtimin e personave të burgosur. Për shembull, OSBE ka kryer vlerësime në lidhje me të drejtat e të burgosurve të vendosur në regjimin e posaçëm. Organizatat ndërkombëtare kanë mundësi të mbështesin të burgosur të huaj, në rast se përfaqësitë e vendeve të tyre nuk gjenden në Shqipëri ose nuk interesohen për ta.

Çfarë parashikon raporti i KPT për Shqipërinë lidhur me keqtrajtimet në burgjet shqiptare?

Në raporte të ndryshme KPT-ja adreson probleme specifike. Për shembull, në raportin e KPT-së për Shqipërinë në vitin 2022, KPT-ja vëren me kënaqësi se, ashtu si gjatë vizitave të mëparshme, delegacioni i saj nuk mori ankesa për keqtrajtim të pacientëve me probleme psikiatrike nga stafi i institucionit në Krujë dhe në Spitalin e Burgut. Lidhur me trajtimin e personave me probleme shëndetësore në Spitalin e Burgut, KPT-ja ka rekomanduar që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapa të menjëhershëm në Spitalin e Burgut për të siguruar që të gjithë pacientët, përfshirë edhe pacientet femra, të jenë të pajisur me dyshekë të pastër dhe shtretër të pastër; t'i sigurohen rregullisht dhe pa pagesë produkte bazë të higjienës personale; që të gjitha pacientet me probleme psikiatrike femra në Spitalin e Burgut të përfitojnë nga ushtrimet e ofruara në natyrë për të paktën dy orë çdo ditë; të kenë akses në televizion dhe radio si dhe në lojëra në tavolinë; të pajisen me një sërë aktivitetesh të përditshme jashtë qelisë.²²

Cilat janë detyrimet e institucioneve në përmbushje të rekomandimeve të KPT-së?

Detyrimet që duhet të përmbushin institucionet janë të ndryshme, në varësi të gjetjeve të konstatuara gjatë vizitës nga KPT-ja. KPT-ja vlerëson nëse detyrimet janë përmbushur plotësisht, pjesërisht apo ka ende detyrime të papërmbushura. Institucionet janë të detyruara të zbatojnë rekomandimet e KPT-së. Disa prej detyrimeve që duhen të përmbushen dhe të respektohen janë:

- shtimi i përpjekjeve për të ndaluar keqtrajtimet fizike të personave të ndaluar nga policia;
- marrja e masave të nevojshme që ankesat për keqtrajtim dhe çdo

²² Raport për Qeverinë Shqiptare bazuar në vizitën *Ad Hoc* në Shqipërinë të kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Johuman ose Trajtimin ose dënimin degradues, 23 - 26 Nëntor 2021.fq.11.

informacion që përmban të dhëna për keqtrajtim të hetohen në mënyrë efektive;

- shmangia e mbipopullit në institucione;
- garantimi i çdo personi të një ekzaminimi nga mjeku dhe jo vetëm bërja e disa pyetje në lidhje me gjendjen shëndetësore;
- kujdesi shëndetësor cilësor dhe i disponueshëm për çdo të dënuar dhe në çdo kohë duke garantuar trajtime me medikamente falas dhe që çdo institucion ka mjetet kryesore të shpëtimit të jetës;
- adresimi i ekzaminimit mjekësor të çdo të dënuari në momentin e pranimit në institucion, regjistrimi i keqtrajtimit dhe raportimi i tyre si dhe mbrojtja e konfidencialitetit të të dhënave mjekësore.
- krijimi i një institucioni për trajtimin e personave që kanë kryer një veprë penale dhe për të cilat gjykata ka vendosur masën “mjekim të detyruar”. Ky institucion duhet të ofrojë trajtim shumëdisiplinor nga stafi që është në varësi të Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- përmirësimi i regjimit për të dënuarit, sidomos ata të dënuar me burgime afatgjata, përfshirë të dënuarit me burgim të përgjeshëm duke zgjeruar aktivitetet jashtë qelisë, përfshirë sportet.

Rekomandimet e adresuara për Shqipërinë botohen në faqen zyrtare të KPT-së dhe nëse Qeveria Shqiptare jep dakortësinë, përkthehen dhe botohen edhe në shqip në faqen e KPT-së, bashkë me përgjigjen e autoriteteve. Një kopje e raportit i përcillet çdo institucioni nga qeveria Shqiptare.

Disa gjetje dhe rekomandime kryesore të Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KPT-së për Shqipërinë 2022²³

- Niveli i zbatimit të rekomandimeve të KPT-së është i ulët;
- Moszbatimi i përpiktë i rekomandimeve të KPT-së sjell për pasojë mosrespektimin/shkeljen e standardeve të kërkuara dhe gjithëpranura të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Implikimet buxhetore në shumicën e rasteve kanë sjellë një ritëm

²³ Avokatit të Popullit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues, vep. ecit. fq. 98-99.

të ulët ose dhe pamundësinë në zbatimin e rekomandimeve dhe për pasojë kanë sjellë kushte dhe trajtim çnjerëzor në respektimin e të drejtave të njeriut;

- Nevoja e hartimit të një plani masash për zbatimin e tij në vijimësi dhe ngritjen e një mekanizmi përgjegjës dhe efikas për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe kontrollin e tyre të herë pas herëshëm nga institucioni epror;
- Nevoja për trajnimin e punonjësve të cilët janë të angazhuar në zbatimin e rekomandimeve;
- Rekomandimet e KPT-së duhet të bëhen pjesë integrale e punës së përditshme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre.

VI. Drejtësia penale, gjykatat dhe ndëshkimi i torturës

Çfarë parashikon Kodi Penal në lidhje me veprat penale të torturës dhe keqtrajtimit?

Kodi penal dënon disa vepra penale si: torturën, shpërdorimin e detyrës, kryerjen e veprimeve arbitrare dhe shkeljen e barazisë së shtetasve.

Neni 86 "Tortura"

Torturë është kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i shkaktohen vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim: a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime; b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër; c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër; ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi; d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet

Neni 87 "Tortura me pasoja të rënda"

Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Neni 248 "Shpërdorimi i detyrës"

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 250 "Kryerja e veprimeve arbitrare"

Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 253 "Shkelja e barazisë së shtetasve"

Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Ku dhe si mund të raportohet një rast keqtrajtimi?

Keqtrajtimi raportohet te drejtuesi i institucionit, te Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, te Komisioni i Ekzekutimit të vendimeve Penale pranë Ministrisë së Drejtësisë, Avokati i Popullit, organizatat e të drejtave të njeriut, në prokurori. Në rast të mosfillimit të hetimit nga prokurori ose pushimit të tij, i burgosuri ka të drejtë të ankohe në gjykatë. Raportimi i keqtrajtimit mund të bëhet edhe nga mbrojtësi (avokati) i të burgosurit.

A ka të drejtë një person i keqtrajtuar të përfitojë mbrojtje ligjore falas?

Po, personi që pretendon se është keqtrajtuar ka të drejtë: të përfitojë kujdes njëkësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale, të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas. Ndihma juridike falas ofrohet në formën e këshillimit dhe informimit nga juristi në institucion. Nëse personi i keqtrajtuar ka nevojë për një mbrojtës që ta përfaqësojë në proces penal ai mund të kërkojë të mbrohet nga një mbrojtës i caktuar i cili zgjidhet nga organi procedues nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë. Çdo i burgosur ka të drejtë t'i kërkojë punonjësit të institucionit ta informojë për mënyrën sesi mund të përfitojë mbrojtje juridike falas.

A ka të drejtë personi i keqtrajtuar të kërkojë një mjek ligjor të pavaruar dhe cili është roli i mjekut ligjor?

Po, personi i keqtrajtuar ka të drejtë të kërkojë një mjek të pavaruar. Roli i tij është të vlerësojë gjendjen e tij, të shenjave, nëse shkaktimi i tyre përkon me kohën kur pretendohet se personi është keqtrajtuar.

E drejta e viktimës për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në proces

Personi (viktima) që pretendon se është keqtrajtuar ka të drejtë të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; të marrë pjesë në proces dhe të dëgjohet vet ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij; të trajtohet me respekt, të mbrohet nga ri-dëmtimi ose riviktimizimi; të komunikojë në gjuhën e tij dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar; të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen; të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale ose organizatat që mbështesin viktimat; të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal; të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifave gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale.

Dëmshpërblimi i viktimës

Personi që është viktimë e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues ka të drejtë të dëmshpërblehet për dëmin e pësuar. Ai ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të ngrejë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil.

E drejta për për t'u drejtuar gjykatës dhe Gjykatës Kushtetuese

Sikurse është theksuar edhe më sipër, çdo person i privuar nga liria që pretendon se është keqtrajtuar ka të drejtën e ankimit në gjykatë. Shqyrtimi i ankimit dhe aksesit në gjykatat shqiptare duhet të jetë efektive. Përdorimi i sistemit të gjykatave të vendit është një kusht, nëse personi që pretendon se është keqtrajtuar, kërkon t'i drejtohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e njohur ndryshe si Gjykata e Strasburgut.

Gjykata Kushtetuese, ndonëse nuk është pjesë e sistemit gjyqësor është një mjet tjetër i brendshëm që gjykon në mënyrë përfundimtare ankesat e çdo individi kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që çënon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutën e Shqipërisë. Për këtë duhen të jenë përdorur mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave.

E drejta për t'u drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

Çdo i burgosur ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës nëse mendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave që parashikon Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pra edhe viktimë e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues. Më parë, i burgosuri ose një familjar i tij (kërkues) duhet të ndjekë çështjen në gjykatat shqiptare dhe në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesa i drejtohet GJEDNJ jo më vonë se 6 muaj nga data e vendimit të formës së prerë së Gjykatës më të lartë të vendit. Për t'u drejtuar Gjykatës, do të ishte e këshillueshme që kërkuesi të asistohet nga një mbrojtës ligjor. Informacionet praktike mbi kriteret e pranimit të kërkesës në gjuhën shqipe gjenden të botuara në adresën: www.echr.coe.int